




KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT
ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Raport i pjeshëm monitorimi

“

Përballë ndotjes shqetësuese si rezultat i mbetjeve dhe përpunimit të hidrokarbureve në Zharrëz, institucionet përgjegjëse heshtin dhe nuk njohin mjaftueshëm detyrat e tyre, reflektojnë mungesë transparence si dhe shfaqin mangësi logjistike në pajisjet për matjen e ndotjes.

”





KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

7 NËNTOR 2022

RAPORT I PJESSHËM MONITORIMI

PËRBALLË NDOTJES SHQETËSUESE SI REZULTAT I MBETJEVE DHE PËRPUNIMIT TË HIDROKARBUREVE NË ZHARRËZ, INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE HESHTIN DHE NUK NJOHIN MJAFTUESHËM DETYRAT E TYRE, REFLEKTOJNË MUNGESË TRANSPARENCE SI DHE SHFAQIN MANGËSI LOGJISTIKE NË PAJISJET PËR MATJEN E NDOTJES

1. Në dt.18 Tetor 2022, një grup monitorimi i Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KShH) realizoi një mision monitorimi në Njësinë Administrative Zharrëz, në Bashkinë Patos të Qarkut Fier, për të verifikuar nivelin e ndotjes së mjedisit, si pasojë e shfaqjes së mbetjeve të hidrokarbureve dhe dëmit real dhe potencial në shëndetin dhe jetën e banorëve të Zharrëzës.

2. Metodologjia e monitorimit u shtri në drejtim të takimit me banorët e zonës, vizitave në terren pranë disa nga zonave më problematike (hot spot) dhe bashkëbisedimi me banorët që jetonin në këto zona, takimit me një sërë institucionesh në nivel vendor apo degët rajonale të institucioneve qendrore¹. Për realizimin e këtyre takimeve dhe vizitave në zonat hot spot, vëzhguesit e KShH-së u asistuan nga dy përfaqësues të Shoqatës Ambientaliste “Zharrëza”.



3. Shqetësimi i parë i banorëve, lidhet me skemën e ndjekur për dëmshpërblimin e tyre, si rezultat i lëkundjeve të vazhdueshme që zona naftënxjerrëse ka patur përgjatë viteve 2012-2016, të cilat kanë shkaktuar edhe dëmtime të mëdha të shtëpive. Në përgjigje të protestave dhe ankesave të banorëve, Këshilli i Ministrave ka miratuar VKM nr. 155, datë 01.03.2017, në bazë e për zbatim të së cilës, kanë përfituar dëmshpërblim të pjesshëm 514 banorë, dhe 70 banorëve të tjerë i janë ri-ndërtuar shtëpitë e dëmtuara. Lidhur me mënyrën e vlerësimit të shtëpive, banorët kanë pretendime se grupet e punës të cilat u drejtuan nga Enti Kombëtar i Banesave, nuk kanë përdorur të njëjtin standard vlerësues, çfarë ka sjellë që skema e dëmshpërblimit të shpërblejë me kosto shumë të ulëta dhe të papërfillshme në raport me dëmet, një pjesë të banorëve. Sipas banorëve, lëkundjet në zonë ndaluan pas hyrjes në fuqi të Urdhërit të Ministrisë së Energjitikës dhe Industrisë “Për ndalimin e injektimit të ujit teknologjik në

¹ Drejtorin e Drejtorisë së Bujqësisë dhe Mjedisit pranë Bashkisë Patos, Drejtorin e Njësisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Fier, Inspektoren e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor Fier, Drejtorin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Fier si dhe Drejtorin e Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë, Gjirokastrë



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

puset gëlqerorë në Zharrëz” të datës 26.12.2017”. Nga ana tjetër, në një raport të CAO² lidhur me lëkundjet në zonë, vërehet se “të dhënat që u konsideruan në një rreze kërkimi (15 dhe 24 km) zbuluan luhatje të rastësishme të normës së sizmicitetit (tipike për aktivitetin sizmik) pa ndonjë korrelacion (pozitiv apo negativ) me shkallën e shfrytëzimit të fushës naftëmbajtëse”.³

4. Problematika më akute dhe afatgjatë për banorët e kësaj zone mbetet ndotja e mjedisit, ku përfshihet ndotja e ajrit, ajo e tokës, mos respektimi i distancës nga zonat e banuara për shkarkimet gjatë operacioneve për hidrokarburet, mos-marrja e masave për rrethimin e gropave në të cilat depozitohen mbetjet e naftës etj. Banorët referojnë se ndotja ka ndikuar edhe në shfaqjen e sëmundjeve të ndryshme tek një pjesë e tyre, ku përfshihen sëmundjet e gjakut, rrugëve respiratorë si dhe sëmundjet kancerogjene në rritje. Në zonë ka një numër të lartë të puseve të fondit të ndaluar me kolona të korroduara (rreth 6000 në të gjithë zonën Patos-Marinëz), gropa në të cilat depozitohen mbetjet e prodhuara nga nxjerrja e naftës (10 të tilla). Sipas banorëve të zonës, institucionet përgjegjëse nuk reagojnë dhe nuk realizojnë as transparencë ndaj tyre, sa i takon treguesve të dhe pasojave që ajo shkakton në jetën dhe shëndetin e tyre.

5. Në këtë zonë janë 2 kompani të cilat ushtrojnë veprimtari në fushën e hidrokarbureve, e më specifikisht Albpetrol dhe Bankers Petroleum.

6. KShH vëren se Bankers Petroleum operon dhe ka të drejta të plota që të ri zhvillojë fushë naftën e rëndë në zonën Patos-Marinëz, si asetin e saj kryesor, ndërsa gradualisht merr përsipër pusët nga Kompania kombëtare shqiptare e naftës, Albpetrol. Kjo kompani ka nënshkruar në vitin 2004 një Kontratë Konçesionare për Marrëveshjen Hidrokarbure, e cila më pas është amenduar në vitin 2008 duke përfshirë edhe zhvillimin dhe prodhimin në fushën e Patos-Marinëzës, e më tej në vitin 2014 është nënshkruar një marrëveshje e dytë ndryshuese ndërmjet “Albpetrol”, sh.a.-së, dhe Bankers Petroleum Albania, Ltd, për “Eliminimin e efekteve ekonomike negative të shkaktuara ndaj Kontraktorit për shkak të ndryshimeve fiskale AKQ”⁴. **KShH vëren se me ndryshimet e vitit 2020 në ligjin Nr.10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”, lejet e tipit C janë shfuqizuar, ndërkohë që në sistemin e QKB për këtë kompani vijon ende të shfaqet si leje e tipit C leja e mjedisit nr. PN-7428-06-2014.**

7. Shoqëria Albpetrol sh.a. është përgjegjëse për kryerjen e Operacioneve Hidrokarbure bazuar në Ligjin Nr.7746, datë 28.08.1993 “Për hidrokarburet” (i ndryshuar), për kërkimin, zhvillim, prodhim, trajtimin, transportin, magazinimin dhe shitjen e naftës bruto, gazit dhe rërave bituminoze brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë si dhe çdo operacion tjetër

² Zyra e Këshilltarit të Përputhshmërisë “Ombudsman” (CAO), është mekanizmi i përgjegjës së pavarur për Korporatën Financiare Ndërkombëtare (IFC) dhe Agjencisë së Investimeve të Garantuara Shumëpalëshe (MIGA), degë të sektorit privat të Grupit të Bankës Botërore. CAO, raporton direkt tek Presidenti i Grupit të Bankës Botërore dhe mandati i saj është të ndihmojë në adresimin e ankesave nga njerëzit e prekur nga projektet e përkrahura të IFC/MIGA, në një mënyrë që është e drejtë, objektive dhe konstruktive dhe që të përmirësojë rezultatet shoqërore dhe mjedisore të këtyre projekteve.

³ https://www.cao-ombudsman.org/sites/default/files/downloads/BankersPetroleumDRConclusionReport_ALB.pdf fq 4

⁴ [BANKERS PETROLEUM ALBANIA LTD \(ish-SAXON INTERNATIONAL ENERGY LTD-ALBANIA BRANCH\)](#)



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

tregtar apo shërbime që i shërbejnë në aktivitetit të shoqërisë”. Sipas informacionit të marrë në faqen zyrtare të QKB, kjo kompani është e licencuar me leje të tipit A dhe B.



8. Vëzhguesit e KShH-së konstatuan ndotje shqetësuese në terren, gjatë vizitave të realizuara pranë Grupit të Pompimit nr. 475, pusit të fondit të ndaluar nr. 326-P dhe gropës ekologjike sektori nr. 7 Zharrëz. Distanca nga shtëpitë e banimit e grupit të pompimit nr.475, nga i cili nxirrej naftë përgjatë 24 orëve pa ndërprerje, ishte rreth 30 metra. Në vendndodhje ndihej një aromë e rëndë hidrokarburesh, ndërkohë që u konstatua edhe

një pajisje e cila qëndronte e ndezur gjatë gjithë kohës për realizimin e shpimeve përkatëse me qëllim nxjerrjen e naftës. Banorët e shtëpive aftër, të shqetësuar, referuan se aroma e rëndë i shoqëron në çdo moment të ditës dhe se nuk mund të hapin as dritaret e shtëpisë për shkak të shqetësimit që i shkakton ndotja në ajër. Uji është jo i pijshëm ndaj detyrohen ta blejnë. Pjesëtarë të familjeve të tyre mjekohen për sëmundjet e gjakut, ndërkohë që prodhimet bujqësore të bahçeve të tyre nuk mund të



shten në



tregun lokal. Gjatë vizitës në pusin e fondit të ndaluar nr.326-P, u konstatua ndotje në sipërfaqe dhe një aromë e rëndë hidrokarburesh. Banorët e kësaj zone, të cilët punonin edhe në një serë për prodhime bujqësore me sipërfaqe të konsiderueshme, nuk pranuan të intervistoheshin nga vëzhguesit dhe kërkuan që të mos filmoheshin, duke konfunduar vëzhguesit e KShH-së me

gazetarë. Gropa ekologjike e Sektorit nr.7 në Zharrëz nuk kishte asnjë gardh apo mjete të tjera rrethuese, ndërkohë që përfaqësues të shoqatës ambientaliste referuan se aty janë derdhur një serë mbetjesh, për të cilat janë vendosur në dijëni institucionet, ndër të cilat edhe Inspektorati Kombëtar i Mjedisit dhe Territorit.

9. Në Bashkinë Patos, vëzhguesit e KShH-së realizuan takim me Drejtorin e Bujqësisë dhe Mjedisit, i cili referoi se janë zhvilluar inspektime të vazhdueshme sa i takon ndotjes që vjen nga operacionet hidrokarbure që shkaktohet nga kompanitë që operojnë në Zharrëz. Kjo Drejtori nuk ka në dispozicion aparatura për matjen e ndotjes, megjithatë në shumicën e rasteve ndotja është evidente nëpërmjet këqyrjes pamore. Lidhur me ndotjen e konstatuar, Bashkia ka përcjellë disa herë shkresa drejtuar kompanive për marrje të masave ndaj ndotjes, dhe për dijëni i janë përcjellë edhe Ministrisë përkatëse të linjës. Për shkak të kompetencave, Bashkia referon se nuk mund të japë sanksione ndaj subjekteve. Sa i takon planeve të masave për reduktimin e ndotjes në këtë zonë, Bashkia nuk ka një plan të tillë, edhe pse sipas nenit



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

26 pika 1 të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Bashkitë janë përgjegjëse për sigurimin, në nivel vendor, të masave për mbrojtjen e cilësisë së ajrit, tokës dhe ujit nga ndotja si dhe realizimin e aktiviteteve edukuese dhe promovuese, në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e mjedisit.

10. Në Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NjKVSH) Fier, vëzhguesit e KShH-së morën takim me Drejtuesin e këtij institucioni, i cili referoi se dispononin mjetet e nevojshme për të realizuar dhe monitoruar vetëm ndotjen e shkaktuar në ujë, të cilat kanë një kohë përdorimi prej afro 40 vitesh por vijnë të jenë funksionale. Analizat dhe matjet në këtë drejtim kryhen çdo ditë, dhe rastet problematike, i përcillen organeve të pushtetit vendor si p.sh. Bashkia Patos, Prefekti i Qarkut Fier, Drejtorisë së Ujësjellës Kanalizimeve, sipas parashikimeve ligjore të nenit 17 pika 2 të ligjit nr. 10138 datë 11.05.2009 “Për shëndetin Publik”. Sa i takon ndotjes akustike, ankesat referohen pranë ISHP, e cila zotëron edhe mjetet e nevojshme për matjen e saj. Kjo praktikë e ndjekur, është në përputhje me nenin 7 të Ligjit Nr.9774, dt.12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”. Sa i takon ndotjes së tokës dhe asaj në ajër, edhe lidhur me këto lloje të saj realizohen matje (pavarësisht se kjo bie ndesh me kapacitetet logjistike të referuara më herët) apo monitorime në raste të ankesave. Për këtë vit u referua se nuk ka patur ankesa lidhur me asnjërin nga këto lloje të ndotjes. NjKVSH referoi gjithashtu se institucioni realizonte edhe monitorim të sëmundshmërisë, por gjatë takimit nuk na u vendosën në dispozicion të dhëna lidhur me të, ndërkohë që pas takimit u kërkua që të bëhej një kërkesë me shkrim për informacion edhe pse kërkesa ju adresua qartazi në formë verbale.

11. Në Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor (ISHSH), vëzhguesit e KShH-së morën takim me Kryeinspektoren e këtij institucioni, e cila referoi se nuk kanë përgjegjësi në fushën mjedisore si dhe nuk kanë patur ankesa nga banorët e Zharrëzës. Ky institucion ka kryer inspektime mbi subjektet që ofrojnë shërbime shëndetësore si dhe gjithashtu kryen inspektime mbi firmat/operatorët privatë të naftës, lidhur me standartet e kushteve të punësimit. Vëzhguesit e KShH-së sollën në vëmendje të Kryeinspektores, nenin 43 të ligjit nr. 10138, datë 11.05.2009 “Për Shëndetin Publik”, i cili parashikon se: **“Të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas apo të huaj, që kërkojnë të ushtrojnë veprimtari në territorin e Republikës së Shqipërisë, i nënshtrohen procesit të vlerësimit të ndikimit në shëndet. Vlerësimi i ndikimit në shëndet realizohet nga Inspektorati Shëndetësor Shtetëror”**. Përkundrejt kësaj kompetence, KShH vëren se ky Inspektorat nuk ka realizuar asnjë raport vlerësimi të ndikimit në shëndetin e banorëve, të veprimtarisë së Albpetrol sha dhe Bankers Petroleum. Sipas Kryeinspektores, raporti i fundit i vlerësimit për zonën Roskovec-Patos, i përket vitit 2015. E pyetur nëse ISHSH ka kryer ndonjëherë inspektime në zonën e Zharrëzës me iniciativën e vet, Kryeinspektorja referoi se veprojnë vetëm kur ka ankesa nga qytetarët. Rrjedhimisht, këto inspektime nuk janë ndërmarrë pasi nuk ka patur ankesa të banorëve. KShH konstaton se bazuar në Ligjin Nr.7643, datë 2.12.1992 “Për inspektimin sanitar”, i ndryshuar, neni 13/b, ISHSH me iniciativën e saj ka detyrimin të monitorojë dhe kontrollojë elementët lidhur me pastërtinë e tokës në qendrat e banuara, të ujërave sipërfaqësore, furnizimin e popullsisë me ujë të mjaftueshëm dhe higjienikisht të pastër, trajtimin e mbeturinave, objektet e shërbimit publik dhe zbatimin e normave sanitare në qendrat e banuara edhe treguesit e shëndetit mjedisor, të rekomanduar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë. Gjithashtu, në ligjin nr. 10433, date 16.06.2011 “Për inspektimin në



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Republikën e Shqipërisë”, neni 43 parashikohet se: ” Inspektorit i njihet e drejta që, me vendim të ndërmjetëm, të marrë masa urgjente⁵, kur:

- a) për shkak të shkeljes së konstatuar të kërkesave ligjore mund të shkaktohet një dëm i menjëhershëm, i rëndë dhe i pariparueshëm i interesit publik apo i palëve të treta, veçanërisht kur është e nevojshme për të shmangur një rrezik të menjëhershëm për jetën apo shëndetin e njerëzve, kafshëve a për mjedisin.
- b) ka një dyshim të arsyeshëm për shkelje të kërkesave ligjore, nga e cila mund të shkaktohet një dëm i menjëhershëm, i rëndë dhe i pariparueshëm, i interesit publik apo palëve të treta dhe është e nevojshme kryerja e verifikimeve të mëtejshme dokumentare ose kryerja e ekzaminimeve apo analizave”.

Sipas informacionit të referuar nga Kryeinspektorja, nuk janë marrë masa urgjente ndaj subjekteve sa i takon dëmeve që mund t’i jenë shkaktuar palëve të treta nga ndotja mjedisore në Zharrëz. Vlen të theksohet se, pas përfundimit të misionit të monitorimit, ISHS Dega Rajonale Fier dërgoi në drejtim të KShH Programin Vjetor të Inspektimeve për vitin 2022 (të miratuar nga Ministria përgjegjëse për shëndetësinë) si dhe inspektimin e fundit të kryer në subjektin Bankers Petroleum LTB. KShH vëren se në programin vjetor evidentohen tematikat inspektuese për çdo muaj, por nuk rezultojnë të jenë parashikuar specifikisht tematika për ndotjen në këtë zonë. Lidhur me praktikën e inspektimit ndaj Bankers Petroleum LTB, rezulton se verifikimi është kryer më datë 18.10.2021 dhe ka patur si objekt zbatimin e rregullave për sigurinë dhe shëndetin në punë nga ky subjekt. Dokumentacioni i praktikës nuk ka konkluduar me shkelje dhe sipas vendimit përfundimtar të inspektimit⁶ nuk jepen sanksione apo detyrime për korrigjim të shkeljeve të konstatuara.

12. Në Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT), Drejtoria Rajonale Fier, vëzhguesit e KShH-së realizuan takim me Drejtuesin dhe përgjegjësën e sektorit të mjedisit së këtij institucioni, të cilët u shprehën se ishin në dijeni të situatës në Zharrëz, për shkak edhe të takimeve me përfaqësues të organizatës ambientaliste Zharrëza. Kjo organizatë kishte përcjellë edhe një ankesë, për të cilën, IKMT kishte ngritur një grup inspektimi në terren për verifikimin e Gropës ekologjike në sektorin nr. 7. Nga inspektimi rezultoi se kjo gropë ishte ndërtuar nga kompania Albpetrol në vitin 2011, subjekt që disponon leje mjedisore të tipit A si dhe gropa ishte e rrethuar. Në fakt, në vizitën në terren që realizuan vëzhguesit e KShH-së pranë kësaj grope, është konstatuar që ajo nuk është e rrethuar dhe nuk përmbush asnjë element të sigurisë, ndërkohë që shoqata ambientaliste referon se kjo gropë nuk ka leje mjedisore. **KShH do të kërkojë informacion në rrugë zyrtare pranë këtij institucioni, lidhur me dokumentacionin e praktikës së inspektimit të kësaj ankese.** Përfaqësuesit e institucionit referuan se bazuar në nenin 21 të ligjit Nr.10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”, IKMT kryen inspektime mbi lejet e tipit B, Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) inspekton lejet e tipit A, ndërkohë që Agjencitë Rajonale të Mjedisit kanë kompetenca për inspektimin e subjekteve që gëzojnë leje të tipit A dhe B. Përkundrejt këtij

⁵ a) ndërprerja e kryerjes së një veprimi, veprimtarie apo një pjese të saj; b) bllokimi dhe ndalimi i hyrjes në mjediset e ushtrimit të veprimtarisë; c) bllokimi dhe marrja në administrim e makinerive, produkteve apo sendeve; d) ndalimi i përkohshëm i hyrjes në territorin e vendit të mallrave, makinerive, produkteve apo sendeve; dh) urdhërimi i subjektit të inspektimit të njoftojë të tretët apo publikun për rreziqet e mundshme

⁶ Nr. ISHS-FR-2021-001588-5 datë 18.10.2021



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

referimi, KShH konstaton në fakt se sipas nenit 24 të ligjit Nr.10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar, Inspektorati Shtetëror Kompetent kryen inspektime në instalimet e tipit A dhe B, në përputhje me dispozitat e ligjit nr.10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe ligjit nr.10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë. **Ndërkohë që neni i referuar drejtuesi i IKMT-së Fier, rezulton të jetë shfuqizuar me ndryshimet që i janë bërë këtij ligji në vitin 2020.** Sa i takon lejeve mjedisore të cilat ky institucion është përgjegjës të monitorojë, pas verifikimit të bazës ligjore përkatëse, vëzhguesit e KShH konstatojnë në përputhje me dispozitat e dy ligjeve të sipërpërmendura, se Inspektorati Shtetëror Kompetent kryen inspektime në instalimet e tipit A dhe B. Ndër kompetencat e tjera të parashikuara në këto dy ligje janë sigurimi i zbatimit të parimit të përgjegjësisë mjedisore si dhe kryerja e kontrolleve, hetimi i zonave të ndotura apo potencialisht të ndotura, si dhe të detyrave e të programit për rehabilitimin e zonës së ndotur. Nga takimi i realizuar, KShH vëren se ky institucion nuk ka ushtruar detyrat mbi përmbushjen e kushteve të lejes përkatëse të mjedisit për subjektet që ushtrojnë veprimtari në këtë zonë.

Sa i takon ushtrimit të kompetencave në raport me institucionet e tjera që kryejnë veprimtari në fushën e mjedisit, përfaqësuesit e institucionit referuan mbivendosje të kompetencave midis IKMT dhe Agjencisë Rajonale të Mjedisit (ARM) për shkak të një vakumi ligjor për gati 2 vite. Kryesisht kompetencat në fushën e mjedisit përgjatë kësaj kohe janë ushtruar nga Agjencia Rajonale e Mjedisit. Drejtuesi i IKMT Fier referoi se në vitin 2022 është miratuar një Urdhër i Ministrit të Brendshëm i cili ndan kompetencat midis këtij institucioni dhe ARM, megjithatë ky urdhër nuk u vendos në dispozicion të vëzhguesve të KShH-së dhe nuk gjendet i publikuar as në faqen e Qendrës së Botimeve Zyrtare.

13. Në Drejtorinë e Agjencisë Rajonale të Mjedisit Fier, Vlorë dhe Gjirokastrë, u realizua një takim me drejtuesin e këtij institucioni, i cili referoi se inspektimi i fundit në Zharrëz është kryer në vitin 2021, pas njohjes me një kronikë televizive e cila fliste për ndotjen në këtë zonë. Referuar takimeve të zhvilluara me përfaqësues të tjerë të institucioneve (siç janë përmendur më sipër), ky është i vetmi rast kur një institucion realizon inspektime me iniciativë. Në përfundim të inspektimit të kryer më datë 28.10.2022, është marrë vendim për pezullimin e aktivitetit të kompanisë Albpetrol, në një sektor të caktuar të ushtrimit të aktivitetit, deri në rehabilitimin e zonës. Kjo masë është ankimuar nga ana e kompanisë me arsyen që ndotja e shkaktuar në zonë nuk është shkaktuar kohët e fundit, por i përket shumë viteve më parë. KShH nuk disponon vendimmarrjen përfundimtare e cila daton në Dhjetor të vitit 2021 dhe ka vendosur masë administrative ndaj kompanisë në masën 100.000 (njëqind mijë) lekë.

Përfaqësuesit e institucionit deklaruan se kanë patur shumë ankesa që vijnë nga banorët e Zharrëzës, dhe mbi bazën e tyre, zona është inspektuar. KShH-së nuk ju vendosën në dispozicion kopje të këtyre praktikave të inspektimit. Gjithashtu, u referua si problematike, mbivendosja e kompetencave midis Agjencisë dhe IKMT-së, të parashikuara në një sërë ligjesh, ku përfshihet Ligji nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, Ligji Nr.10 448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar, Ligji Nr.10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” etj. Sipas përfaqësuesve të këtij institucioni, dallimet midis të dy institucioneve kanë të bëjnë me gamën e subjekteve që mund të inspektohen, ku përmendi se Agjencia Rajonale e Mjedisit mundet të inspektojë vetëm



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

subjektet që gëzojnë një leje, ndërkohë që IKMT mundet të inspektojë edhe subjektet pa leje. Në ndryshim nga përfaqësuesit e IKMT dega Fier, sipas përfaqësuesve të Agjencisë, u referua se nuk ka ende një akt nënligjor i cili detajon në mënyrë të ndarë kompetencat midis tyre.

Konkluzione

✚ KShH vëren se në njësinë administrative Zharrëz, situata sa i takon ndotjes mjedisore është alarmante, duke u kthyer kështu në një rrezik për shëndetin dhe jetën e banorëve të zonës. Afërsia e zonave të banimit dhe serave të produkteve bujqësore me vendet ku nxirret apo shërbejnë si vendgrumbullime apo puse të vjetra, të mbetjeve të hidrokarbureve, në mungesë të masave të sigurisë dhe masave rehabilituese, është tepër shqetësuese.

✚ Mosreagimi i institucioneve përgjegjëse, e ka përkeqësuar situatën, duke përçuar një klimë të mungesës së iniciativës në inspektimet *ex officio* dhe mungesën e ndëshkimit të operatorëve që ushtrojnë veprimtari në fushën e hidrokarbureve në këtë njësi administrative, përkatësisht Albpetrol sha dhe Bankers Petroleum.

✚ Institucionet përgjegjëse shmangin përgjegjësitë, duke referuar jo vetëm njohje jo të mirë të tyre nga pikëpamja ligjore, por njëkohësisht mungesë të mjeteve logjistike për matjen e ndotjes por edhe mbivendosje kompetencash.

✚ Institucionet përgjegjëse në përgjithësi shfaqin mungesë transparence për vendosjen në dispozicion të dokumentacionit që evidenton ushtrimin e kompetencave të tyre ligjore dhe marrjen e masave parandaluese/ndëshkuese për ndotjen në Zharrëz, edhe pse ishin njohur paraprakisht me vizitën monitoruese të ekipit të KShH-së, ndërkohë që kërkonin që ky dokumentacion të aksesohet vetëm me kërkesa zyrtare për informacion.